



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.44

17 prill

2009

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr.336, datë 15.4.2009	Për kompensimin e pagesës për pajisjen me letërnjoftim të shtresave në nevojë	2231
Vendim i KM nr.361, datë 1.4.2009	Për një shtesë në vendimin nr.15, datë 14.1.2009 të Këshillit të Ministrave “Për kompensimin e pagesës për pajisjen me letërnjoftim të shtetasve në nevojë”	2233

VENDIM
Nr.336, datë 15.4.2009

**PËR KOMPENSIMIN E PAGESËS PËR PAJISJEN ME LETËRNJOFTIM TË SHITESAVE
NË NEVOJË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kompensimin e çmimit të letërnjoftimit për shtetasit shqiptarë, mbi 18 vjeç ose që deri më 28 qershor 2009 mbushin 18 vjeç, që nuk disponojnë pasaportë udhëtimi për jashtë shtetit, si më poshtë vijon:

a) Në masën 1200 (një mijë e dyqind) lekë për të gjithë personat:

i) Paraplegjikë dhe tetraplegjikë, personat e verbër dhe pjesëtarët e familjes, në ngarkim të tyre, kur nuk kanë të ardhura;

ii) që vuajnë dënimin ose ndodhen në paraburgim;

iii) anëtarë të komunitetit rom dhe egjiptian.

b) Në masën 1000 (një mijë) lekë për:

i) të gjithë pensionistët, që kanë pension minimal, në qytet, dhe të gjithë pensionistët e fshatit;

ii) studentët e institucioneve të arsimit të lartë publik;

iii) çdo anëtar i familjeve, që trajtohen me ndihmë ekonomike;

iv) të gjithë shtetasit, që votojnë për herë të parë, ata që kanë lindur në periudhën 19.2.1989-28.6.1991, pavarësisht nga gjendja ekonomike dhe sociale.

c) Në masën 700 (shtatëqind) lekë për personat:

i) me aftësi të kufizuar, të lindur ose të bërë të tillë, të cilët deklarohen të paaftë për punë me vendim të KMCAP-së, në përputhje me pikën 3 të nenit 7 të ligjit nr.9355, datë 10.3.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", si dhe anëtarët e familjes, kur personi me aftësi të kufizuar është kryefamiljar, me përjashtim të paraplegjikëve dhe tetraplegjikëve dhe të të verbërve.

ii) personat që përfitojnë pagesë papunësie.

ç) Në masën 400 (katërqind) lekë për të gjithë personat, që përfitojnë pension pleqërie mbi pensionin minimal në qytet, të plotë, të pjesshëm ose pension invaliditeti, si dhe personat në ngarkim të tyre, të cilët janë pa të ardhura.

d) Në masën 200 (dyqind) lekë për punonjësit e institucioneve buxhetore me pagë mujore bruto jo më të madhe se 35 000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë, si dhe personat në ngarkim të tyre pa të ardhura.

2. Pagesa e kompensimit bëhet për aplikimet e kryera deri në 20 qershor 2009 apo letërnjoftimet e marra deri më 28 qershor 2009. Për aplikimet e bëra pas 20 qershorit 2009 kompensimi është i pavlefshëm dhe çdo pagesë e marrë për këtë qëllim është e paligjshme.

3. Kompensimin e pagesës për pajisjen me letërnjoftim e përfitojnë edhe shtetasit e kategorive të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi dhe studentët, në institucionet e arsimit të lartë privat, të cilët kanë pasaportë udhëtimi për jashtë shtetit, por kanë aplikuar ose janë pajisur me letërnjoftim deri në hyrjen në fuqi të këtij vendimi.

4. Pagesa e kompensimit të bëhet si më poshtë:

a) Për pensionistët e përmendur në pikat 1 e 3 të këtij vendimi, të bëhet së bashku me pagesën e pensionit, duke filluar nga data 1 maj 2009, në zyrat e institucioneve ku paguhen pensionet.

b) Universitetet publike t'i blejnë, paraprakisht, kuponat dhe t'i pajisin me to të gjithë studentët, që nuk e kanë kryer aplikimin, kundrejt pagesës së diferencës, ndërmjet çmimit të kuponit dhe masës së njohur të kompensimit. Studentëve, që e kanë kryer aplikimin apo e kanë marrë letërnjoftimin t'ua japin kompensimin, në masën e përcaktuar në nënndarjen "ii" të shkronjës "b" të pikës 1 të këtij vendimi, pasi të kenë dorëzuar kopjen e formularit të aplikimit ose kopjen e letërnjoftimit të marrë.

c) Drejtoritë arsimore në rrethe t'i blejnë, paraprakisht, kuponat dhe t'i pajisin me to nxënësit, votues për herë të parë, të shkollave të mesme publike, të përcaktuar në nënndarjen "iv", të shkronjës "b" të pikës 1 të këtij vendimi, kundrejt pagesës së diferencës, ndërmjet çmimit të kuponit dhe masës së njohur të kompensimit. Nxënësve, që e kanë kryer aplikimin apo e kanë marrë letërnjoftimin t'ua japin kompensimin, në masën e përcaktuar në nënndarjen "iv" të shkronjës "b" të pikës 1 të këtij vendimi pasi të kenë dorëzuar kopjen e formularit të aplikimit ose kopjen e letërnjoftimit të marrë.

ç) Zyrat e punës në rrethe të blejnë, paraprakisht, dhe t'i pajisin me kupona personat e përcaktuar në nënndarjen "i" të shkronjës "c" të pikës 1 të këtij vendimi, kundrejt pagesës së diferencës, ndërmjet çmimit të kuponit dhe masës së njohur të kompensimit. Personat, që e kanë kryer aplikimin apo e kanë marrë letërnjoftimin, t'ua japin kompensimin, në masën e përcaktuar në nënndarjen "ii" të shkronjës "c" të pikës 1 të këtij vendimi, pasi të kenë dorëzuar kopjen e formularit të aplikimit ose kopjen e letërnjoftimit të marrë.

d) Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve të blejë dhe të pajisë me kupona personat e përcaktuar në nënndarjen "ii" të shkronjës "a" të pikës 1 të këtij vendimi.

dh) Bashkitë dhe komunat t'i blejnë, paraprakisht, kuponat dhe t'i pajisin me to të gjithë qytetarët e përcaktuar në pikën 1, shkronja "a", nënndarjet "i" e "iii", "b", nënndarjet "iii" e "iv", dhe "c", nënndarja "i" të këtij vendimi, kundrejt pagesës së diferencës, ndërmjet çmimit të kuponit dhe masës përkatëse të njohur të kompensimit. Personave që e kanë kryer aplikimin apo e kanë marrë letërnjoftimin t'ua japin kompensimin, në masën e njohur në muajin pasardhës, pasi të kenë dorëzuar kopjen e formularit të aplikimit ose kopjen e letërnjoftimit të marrë.

Bashkitë e komunat të kryejnë pagesat vetëm për personat e përcaktuar në nënndarjen "iv", të shkronjës "b" të pikës 1 të këtij vendimi, të cilët nuk janë studentë apo nxënës, në shkollat publike.

Për evidentimin e personave të komunitetit rom dhe të komunitetit egjiptian, që nuk trajtohen me ndihmë ekonomike ngrihet, pranë çdo bashkie e komune, një komision verifikimi, i përbërë nga tre persona: një pjesëtar i administratës së ndihmës ekonomike të bashkisë/komunës përkatëse, një person i propozuar nga prefekti dhe një nga këshilli bashkiak/komunal përkatës. Komisioni fton, për evidentimin e personave të këtyre komuniteteve, edhe përfaqësues të vetë komuniteteve.

e) Institucionet e mësipërme, blejnë, paraprakisht, kuponat e aplikimit ose të bëjnë pagesën e kompensimit për përfituesit, me fondet buxhetore, të miratuara për këto institucione ose me të ardhurat e arkëtuara për llogari të tyre, në procesin e zbatimit të Buxhetit të Shtetit dhe të njësive të qeverisjes vendore.

ë) Institucionet respektive, në bazë të kopjeve të formularëve të aplikimit ose të kopjeve të letërnjoftimeve të përfituesve të kompensimit, kërkojnë në Ministrinë e Financave rimbursimin për pagesat e kryera, sipas rregullave të përcaktuara në këtë vendim.

f) Nëse përfituesit e kompensimit nuk paraqesin dokumentacionin që kërkohet deri më 20 qershor 2009, institucionet nuk do të rimbursohen për pagesat e bëra, por pagesat e bëra paradhënie për përfituesit u mbahen këtyre të fundit nga listëpagesa e përfitimeve përkatëse të muajit/ve pasardhës ose ata shpallen debitorë dhe vjelja e detyrimit bëhet, sipas procedurave për vjeljen e debitorëve.

5. Në rast se institucionet përgjegjëse ose njësitë e qeverisjes vendore nuk disponojnë fonde për blerjen e kuponave, në përputhje me këtë vendim, degët e thesarit lejojnë avancimin e fondeve të muajve pasardhës deri në plotësimin e shumës së kërkuar. Në rast se edhe kjo është e pamundur, institucionet përgjegjëse ose njësitë e qeverisjes vendore bëjnë kërkesë për shtesë fondesh, në Ministrinë e Financave.

6. Rimbursimi i institucioneve të bëhet në fund të çdo muaji, sipas kësaj procedure:

a) Institucionet buxhetore dhe njësitë e qeverisjes vendore paraqesin, për bashkitë/komunat, përkatësisht në ministrinë/institucionet qendrore, nga të cilat varen, dhe në Ministrinë e Brendshme listëpagesën e përfituesve të kompensimit të paguar për muajin përkatës, së bashku me fotokopjet e aplikimeve ose fotokopjet e letërnjoftimeve të përfituesve.

b) Ministrinë dhe institucionet qendrore verifikojnë listëpagesën dhe dokumentet bashkëlidhur dhe, kur i gjejnë të rregullta, i pranojnë dhe përgatisin një përmbledhëse të tyre, të cilën e paraqesin në Ministrinë e Financave, në formën e një kërkesë për rimbursimin e fondeve të shpenzuara. Listëpagesat auditohen nga auditi i brendshëm i secilit institucion dhe arkivohen, për ruajtje dhe auditim të jashtëm, në ministrinë dhe institucionet qendrore respektive.

c) Ministria e Financave bën pranimin e përmbledhjes së listëpagesave dhe, kur i gjen të rregullta, bën çeljen e menjëhershme të fondeve, në favor të ministrive dhe institucioneve qendrore.

ç) Ministrinë dhe institucionet qendrore bëjnë, më tej, rimbursimin për institucionet vartëse dhe njësitë e qeverisjes vendore, sipas procedurave për çeljen e fondeve buxhetore.

7. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, në shumën 500 000 000 (pesëqind milionë) lekë, të përballohen nga fondi rezervë i vitit 2009.

8. Rregullat e hollësishme dhe mënyra e pagesës së kompensimit të çmimit të letërnjoftimit përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.

9. Vendimi nr.15, datë 14.1.2009 i Këshillit të Ministrave “Për kompensimin e pagesës për pajisjen me letërnjoftim të shtresave në nevojë”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.361, datë 1.4.2009

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.15, DATË 14.1.2009 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KOMPENSIMIN E PAGESËS PËR PAJISJEN ME LETËRNJOFTIM
TË SHITESAVE NË NEVOJË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pas pikës 1 të vendimit nr.15, datë 14.1.2009 të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 1.1, me këtë përmbajtje:

“1.1. Shtetasve, që nuk disponojnë pasaportë udhëtimi për jashtë shtetit, do t’u kompensohet pagesa për pajisjen me letërnjoftim në shumat, si më poshtë vijon:

a) Në masën 900 (nëntëqind) lekë:

i) të gjithë pensionistëve, që kanë pensione minimale, në qytet dhe të gjithë pensionistëve, në fshat, të cilët kanë aplikuar deri më tani apo do të aplikojnë deri në 1 maj 2009.

ii) të gjithë personave, që vuajnë dënimin, në kushtet e paraburgimit ose të burgimit.

b) Me kusht që të kenë aplikuar deri më tani apo që do të aplikojnë deri më 1 maj 2009, në masën 1000 (një mijë) lekë;

iii) të gjithë studentëve;

iv) të gjithë atyre, që përfitojnë ndihmë ekonomike, për shkak të papunësisë;

v) të gjithë atyre, që deri më 28 qershor 2009 mbushin 18 vjeç dhe votojnë për herë të parë;

c) Për të gjithë personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë, si dhe për personat e verbër, masa e kompensimit është në vlerën e plotë të letërnjoftimit.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2009 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 17.4.2009
Doli nga shtypi më 17.4.2009

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2009

Çmimi 8 lekë